

## NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore në Ferizaj-Dega në Kaçanik , Departmenti I Përgjithshëm, përmes gjyqtarit të vetëm gjykues Shabi Idrizi dhe Sek. Juridike, Shpresa Hoxha, në lëndën penale të akuzuarit [REDACTED] nga f. [REDACTED], komuna e Kaçanikut i akuzuar për shkak të veprës penale, vjedhje pylli nga neni 358 paragrafi 2 të KPK-së, sipas aktakuzës së Prokuroris shtetore në Ferizaj PP/II.nr. 1007-6/14 të datës 24.10.2014, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor oral dhe të hapur më 13.12.2016, në prezencë të Prokurorit shtetror Agim Kuka, deshmitarit [REDACTED] dhe të akuzuarit [REDACTED], muarr dhe të njenjtën ditë shpalli publikisht këtë:

### A K T G J Y K I M

I akuzuari [REDACTED] nga i ati [REDACTED] dhe nëna [REDACTED] e lindur [REDACTED] i lindur [REDACTED] në f.X [REDACTED], Komuna e Kaçanikut ku edhe jeton, pregaditja shkollore shkolla fillore, i papunë, i gjendjes së varfër ekonomike, i pamartuar, I denuar edhe me parë, shqiptar nënshtetas Kosovar, mbrohet në liri, numri personal [REDACTED], mbrohet në liri.

### Ë S H T Ë F A J T O R

Se me dt 29.03.2014 , rreth orës 16:20 , pyllin shoqërorë të cilin e menaxhon Autoriteti pyjor Komunal –Hani i Elezit në rajonin ekonomik pyjor Bodoshnjak në vendin e quajtur “Rrofshi Lopeve “, me qëllim vjedhje me sopat sharrë motorike , ka prerë 3 copa dru të llojit bung me dimensione të gjata 17 m, me diametër 54 cm gjithsejtë në kubaturë prej 6.54 m. kube, të cilat i ka transportuar me kali samari, vlera e dëmit të shkaktuar është 523.20 €.

Me këtë veprim kreu veprën penale vjedhje pylli nga neni 358 par.2 të KPK-së

Andaj duke u bazuar në dispozitën e lartcekur dhe nenin 3, 41, 50,51 , , 75 të KPK-së dhe nenit 365, 453 dhe 463 të KPPK-së i shqipton

### D E N I M M E K U S H T

Ashtu që të akuzuarit [REDACTED] i shqipton denim me burg në kohëzgjatje prej 90 (nëntëdhjet) ditëve dhe dënim me gjobë në lartësi prej 150 euro, i cili nuk do të ekzekutohet po që se në fat prej një viti( koha e verifikimit) pas plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale..

Obligohet i pandehuri që t'ia kompenzoj dëmin të dëmturës në vlerë prej 523.20 euro.

I pandehuri obligohet që të paguaj në emër të shpenzimeve procedurale shumën prej 20,00 euro.

### A r s y e t i m

PTH- nga Ferizaji, me aktakuzën e vet .PP/II. nr. 1007-6/14 të datës 24.10.2014, të akuzuarin [REDAKTUAR] nga f [REDAKTUAR], Komuna e Kaçanikut, e ka akuzuar për shkak veprës penale Vjedhje pylli nga neni 358 par.2 të KPK-së.

Në shqyrtimin fillestar-gjyqsor Prokurori shtetror pranë PTH-Agim Kuka në mbeti në tërsi pranë aktit akzues të paraqitur me shkrim pranë kësaj gjykate pa ndryshime dhe plotsime, duke propozuar gjykatës që të akuzuarin [REDAKTUAR] nga f. [REDAKTUAR] të e shpall fajtor për veprën penale që akuzohet dhe ti shqiptohet denim meritor sipas ligjit .

I akuzuari [REDAKTUAR], në mbrotjen e tij në shqyrtimin gjyqsor në tërsi pranon kryerjen e veprës penale që i vëhet në barrë sipas aktit akzues dhe njëherit është penduar për këtë veprë penale, dhe propozon që gjykata të ia shqipton një denim sa më të butë, pasqë këtë veprim e ka bërë nga nevoja e jo se kishte dëshirë ta bënte dhe se prej kësaj kohe nuk është marrë fare me vjedhje të pyllit dhe se ka gjendje ekonomike shumë të veshtirë.

Pasiqë gjykata ka fituar bindjen se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit për veprën penale që i vëhet në barrë dhe është e bindur se pranimin e kanë bërë në baza vullnetare duke u mbështetur në nenin 248 të KPPK edhe në faktet dhe provat që përmban aktakuza por edhe në shkresat e lendes, ka gjetur se janë përmbushur kushtet ligjore nga neni 248 par 4 të KPPK-së dhe shqyrtimin e ka përfunduar pa administrimin e provave tjera.

Gjykata ka vlersuar se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë të gjitha tiparet e veprës penale vjedhje pylli nga neni 358 par.2 të KPK-së për të cilën veprë i akuzuari është penalishtë përgjegjës dhe është ndeshkuar si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Me rastin e matjës së denimit gjykata i ka pasur parasysh të gjitha rrethanat nga neni 75 i KPK-së të cilat ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit. Si rrethanë lehtësuese për të akuzuarin gjykata ka marrë për bazë pranimin e fajit nga i akuzuari, pendimin e tij, sjelljen e mirë të tij gjatë tërë procedurës si dhe në shqyrtimin gjyqsor, se është familiar, kurse për bazë për llojin dhe lartsin e denimit ka

marrë parashysh gjendejne e veshtirë të tij ekonomike, kurse rrethane renduse faktin se kjo dukuri është mjaft e përhapur.

Gjykata është e bindur se denimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit është në harmoni me shkallën e pergjegjsise penale të tij dhe peshën e vepres penale, keshtu që denimi i shqiptuar në lartësi si në dispozitiv të aktgjykimit , do arrihet qëllimi i denimit i paraparë me nenin 41 të KPK-së dhe atë efektin rehabilitues ndaj të akuzuarit, efekt preventiv ndaj të tjerëve për moskryerjen e një veprimi i cili është i sanksionuar dhe i denushëm si dhe reagimin e shoqrisë ndja një veprimi të tillë të ndaluar dhe të ndëshkushëm me ligj.

Vendimi mbi shpenzimet e procedures është i mbshtetur në dispozitën e nenit 453 të, KPPK-së ,

Vendimi mbi kompenzimin e palës së dëmtuar është i bazuar në dispozitat e nenit 463 të KPPK-së

Nga të cekurat e mësipërme u vendos si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

### GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Dega në Kaçanik

P. nr. 354/14

Me. 13.12.2016

Sek. Juridike,  
Shpresa Hoxha

Gjyqtari,  
Shabi Idrizi

KËSHILLA JURIDIKE ;Kundër këtij aktgjykimi mundet të pshtrket ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, permes kësaj Gjykate.

